

EPPC Albania për klientin e saj, kërkon një **Specialist për Identifikimin e Klientëve të Rinj**.

## Përgjegjësitë kryesore:

- Identifikimi i segmenteve të tregut me potencial të lartë për zhvillimin e biznesit, duke përdorur burime të dhënash dhe analiza statistikore;
- Analizimi i trendeve të industrisë dhe lëvizjeve të konkurrentëve për të sugjeruar strategji inovative;
- Mbledhja e informacioneve të sakta mbi klientët potencialë, përmes intervistave fillestare, rrjeteve profesionale dhe platformave digjitale, duke përfshirë të dhëna specifike mbi biznesin dhe kontaktet kyç;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në takime fillestare për ndërtimin e një rrjeti të fortë kontaktesh;
- Mbledhja e informacionit mbi produktet, çmimet dhe strategjitë promovionale të konkurrentëve;
- Raportimi tek Supervizori mbi ndryshimet në treg dhe mundësitë për diferencim;
- Përpilimi i raporteve javore të detajuara mbi aktivitetet dhe rezultatet e arritura, duke ndjekur një format standard që do të përfshijë pikat kryesore si numri i klientëve të identifikuar, përparimi në negociata dhe sfidat kryesore të hasura;
- Rekomandimi i strategjive të reja për ndërtimin e marrëdhënieve me klientët potencialë;
- Shitja aktive e shërbimeve kryesore të kompanisë;
- Pjesëmarrja në takime për të prezantuar produktet dhe shërbimet e kompanisë;
- Sigurimi i një përvoja pozitive dhe profesionale për klientët potencialë.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare në Marketing, Administrim Biznesi ose fushë të ngjashme;
- Minimumi 1-2 vite përvojë në shitje ose hulumtim tregu;
- Njohuri të avancuara në mjete CRM dhe analiza tregu;
- Aftësi të forta komunikimi, negociuese dhe ndërtimi të marrëdhënieve profesionale;
- Disponueshmëri për udhëtime brenda vendit.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.